

STUDIA ALBANICA II

In memoriam
Wacław Cimochowski



pod redakcją
Ireny Sawickiej



Wydawnictwo Uniwersytetu Mikołaja Kopernika
Toruń 2005

Druk pracy dofinansowany z grantu 804-FI.

ISBN 83-231-1876-0

Printed in Poland

© Copyright by Wydawnictwo Uniwersytetu Mikołaja Kopernika
Toruń 2005

Wydawnictwo Uniwersytetu Mikołaja Kopernika
Redakcja: ul. Gagarina 39, 87-100 Toruń
tel: (056) 611 42 95, fax: 611 47 05
dwyd@uni.torun.pl

Dystrybucja: Biuro Promocji, ul. Reja 25, 87-100 Toruń
tel./fax (056) 611 42 38, books@umk.pl
www.wydawnictwo.uni.torun.pl

Wydanie pierwsze. Nakład 250 egz.
Skład: Dział Wydawnictw UMK
Druk: Zakład Poligrafii UMK

Mbylltoret e shqipes. Cilësia e tyre fonetike, gjatësia dhe VOT-i

Abstract. *This is a first attempt to establish the acoustic characteristics of Albanian stops in three different areas in which Albanian is spoken, Albania (threespeakers), Kosova (one speaker) and Italy (two speakers of the Arbëresh minority group). The core of the experiment is the measurement of the acoustic parameter of VOT in these three varieties of Albanian language in order to point out whether there exist any inner differences. Albanian stops are also compared to Italian, English, Spanish, Dutch, Hungarian and Tamil stops.*

1. Hyrie

Për sa u përket mbylltoreve gjuha shqipe paraqet një seri të plotë me tetë fonema, të ndarë në dy kategori: të pazëshme dhe të zëshme:

/p t c k/
/b d ɟ g/

të cilat realizohen nga ana fonetike me shumë homogjenitet brenda dialekteve si edhe në variantet krahinore të gjuhës standarde me përjashtim të çiftit të fonemave qiellzore /c ɟ/, që në arealin verior të Shqipërisë shqiptohen të afrikuar dhe u afrohen tingujve [tʰ dʒ] ~ [tʃ dʒ]. Bivington (1974) për këta tinguj propozon një matricë me tipare dalluese si vijon poshtë:

	p	b	t	d	q	gj	k	g
buzor	+	+						
kunonor			+	+				
i lartë					+	+		
i prapëm							+	+
i zëshëm		+		+		+		+

Shqipja nuk paraqet, për bashkëtingëlloret, kundërvënie fonologjike gjatësisë midis tingujve të thjeshtë dhe tingujve të gjatë siç kemi theksuar në Belluscio (1993), dhe s'ka një rregull drejtshqiptimi të mirëfilltë¹. Për këtë arsye nuk është e thjeshtë të caktohet një shqiptim 'standard' megjithëse, të tre subjektet shqiptare, shqiptimin e të cilëve kemi regjistruar, të cilët kanë qenë (2) dhe janë (1) lektorë të gjuhës shqipe në Universitetin e Kalabrisë, kanë pohuar se përdorin një shqiptim standard, por kemi vërejtur se, megjithëse shqiptimi i tyre ishte tepër i kontrolluar, ata në të vërtet prodhonin një variant krahinor të shqipes, dhe në bazë të prejardhjes gjeografike të tyre, shqiptimi cilësohet me ndikimin e dialektit. Folësi A.B. nga Prishtina p. sh., për zanoret, paraqet kundërvënie gjatësisë, shqiptimin e /a/ si të prapme ose të buzorëzuar, shurdhimin e bashkëtingëlloreve të zëshme në pozicionin fundor, fshirjen e /ə/ në pozicion fundor; folësi J.M., nga krahina e Lushnjës, paraqet shqiptimin e /ə/ të theksuar si [e]; folësi GJ.SH. nga Shqipëria e Veriut shpeshherë në bisedë të lirë paraqet shqiptimin e /l-së/ si /ð/ në disa kontekste të caktuara, dhe shqiptimin e /q-së/ tepër të qiellzorëzuar dhe të afrikuar. Ndërsa, për sa i përket fonemave bashkëtingëllore mbylltore këtu në shqyrtim, nga ana perceptuese, ata nuk paraqesin ndryshime veç nga ana e zgjatjes së fazës mbyllëse.

Weigand (1913) jep një përshkrim të mbylltorëve duke thënë: “*p t k* janë shqiptuar me një frymëthithje të lehtë dhe *b d g* si të shurdhëta të dobësuar ashtu si në Gjermaninë Qendrore. [...] edhe në pozicionin fundor *b d g* janë shqiptuar të shurdhëta, por mbeten të dobëta (si në rumanishte), kurse në toskërishte, në këtë rast, ata paraqiten të fortë (si në bullgarishte)”.

Lowman (1932), në rastin e /t/ thotë se ajo del si “slightly aspirated in all positions” (dmth. si pak e frymëtuar në të gjitha pozitat).

Cimochowski (1951:12) pohon: “*p*-ja është një bashkëtingëllore dybuzore. Sipas mënyrës së nyjetimit ajo është një bashkëtingëllore e shurdhët e fortë. Shpërthimi i buzës së mbyllur është ashtu i fortë sa dëgjohet qartë [...] si pjesë përbërëse e veprimtimit nyjetimor.

Haebler (1965): pohon se për *p*, *t*, *q* dhe *k* frymëthithja është shumë e dobët.

¹ Mbi drejtshqiptimin e shqipes shih Dodi (1983), f. 137–164, ku pohohet se drejtshqiptimi i shqipes varet dhe nxiret drejtëpërdrejtë nga grafia e gjuhës, por asgjë thuhet aty për mbylltoret veç se një shpjegim të shkurtër për dukurinë e shurdhimit të mbylltoreve të zëshme në trup dhe në fund të fjalës. Bevington (1974: 3–4) duke cituar një shkrim të Dodit të vitit 1967, thotë: “The literary language is, of course, primarily a written and not a spoken idiom, but an orthoepic pronunciation is developing and we will assume that the facts of pronunciation of the official language are easily interpretable from orthography”.

Beci (1977) për shkodranishten jep edhe disa të dhëna për mbylltoret p. sh. “/p/. La fermeture des lèvres se réalise talemment, mais sans beaucoup d’effort. /p/ est une occlusive non-aspirée”, “/d/. Dans toutes les positions, le /d/ n’est pas aspirée”, gjithashtu për çdo fonemë bashkëtingëllore jep edhe *locus*-in dhe frekuencat e shpërthimit.


Dodi (1983) popozon vetëm përshkrime nyjëtimore, p. sh. thotë: (f. 59, §57) për /p/ “hapja e pengesës bëhet me shpërthim”, dhe për /b/ “shqiptohet me një rrymë ajri më të dobët”. Për /t d/ (p. 62 §60): “mbyllja që formon gjuha hapet me shpërthim, prandaj në nyjëtimin e tyre nuk vihet re afrikimi”.

Vetëm Buchholz-Fiedler (1987) japin një përshkrim më të saktë të mbylltoreve megjithë se mbështeten mbi të dhëna perceptive dhe jo elektroakustike: “*p* mezi e frymëtuar; *t* me afrikim të theksuar para zanoreve *i-y*, frymëtim minimal para bashkëtingëlloreve dhe më shumë para zanoreve të përparme; *q* me afrikim të fortë sidomos në të folurit të shpejtë; *gj* me frymëtim më të vogël, *k* me frymëtim të lehtë, por më të fortë se sa për *p* dhe *t* dhe më të dobët se në rastin e *q*”.

Siç del qartë, dhe siç dihet, shqipja në sistemin fonologjik nuk paraqet mbylltore të frymëtuara por ka edhe disa raste në të cilat vetëm nga ana fonetike mund të degjohet një shqiptim pak a shumë i frymëtuar.

2. Voice Onset Time ose Koha e Goditjes së Zëshmisë

Për studimin e VOT-it na duhet të nisemi nga puna themelore e Lisker & Abramson (1964), duke kaluar në trajtesa të mëpastajshme në Ladefoged (1975), Abramson (1977), dhe në zgjerimet dhe në shtesat e Lisker-it (1978). VOT-i mund të caktohet në mënyrë të thjeshtë si një interval kohe që bie midis fundit e fazës mbyllëse e nyjëtimin të një tingulli mbylltor dhe goditjes e dridhjeve të glotës, gjë që cakton fillimin e nyjëtimin të tingullit zanor, si mund të vihet re në këtë diagram (sipas Henton, Ladefoged dhe Maddieson 1992).



VOT-i paraqitet si një parametër akustik tepër i rëndësishëm për caktimin e kundërvënieve brenda klasave të ndryshme të mbylltoreve: të shurdhëta (jo të frymëtuara dhe të frymëtuara) dhe të zëshme (jo të frymëtuara dhe të frymëtuara).

Lisker & Abramson (1964) përcaktojnë për VOT-in tre kushte: *voicing lead* (për mbylltoret e zëshme) dmth. dridhje të glotës që u paraprijnë dridhjeve të zanores pasuese, *short voicing lag* (për mbylltoret jo të frymëtuara) dmth. heshtje e shkurtër para dridhjes së glotës për nyjetimin e zanores pasuese, dhe *long voicing lag* (për mbylltoret të frymëtuara) dmth. heshtje e gjatë para dridhjes së glotës për nyjetimin e zanores pasuese.

Mbylltoret e zëshme tregojnë në sonogram një vijë zëshmije, që i paraprin shpërthimit të bashkëtingëllores së zëshme, e cila ka vlerë negative dhe është e njohur si *voicing lead* ose VOT negativ.

Mbylltoret e shurdhëta tregojnë në sonogram një interval heshtjeje pak a shumë të gjatë midis shpërthimit dhe goditjes së dridhjes së glotës; për nyjetimin e zanores pasuese, ky interval është VOT-i i mirëfilltë dhe mund të ndahet në *short* ose *long voicing lag*.

VOT-i ka një zgjatje të brendshme që varet nga vendi i nyjetimit të mbylltoreve si edhe nga vendi i bashkëtingëllores në fjalë (p. sh. VOT-i është më i vogël në trup sesa në fillim të fjalës); ka një zgjatje më të madhe ose më të vogël kur mbylltoret janë të frymëtuara ose jo të frymëtuara, kur janë të thjeshta ose të dyfishuara (Hahn 1992 për japonishten) dhe, në fund të fundit, zgjatja e VOT-it shënon shqiptimet e ndryshme të mbylltoreve në gjuhët e ndryshme të botës.

Për sa i përket inventarit të fonemave mbylltore të gjuhëve, Lisker & Abramson (1964) vendosin tri grupe: *gjuhë me dy kategori mbylltoresh* si p. sh. holandishtja, spanjishtja e Puerto Rikos, hungarishtja, gjuha tamil dhe anglishtja (ose gjuhë vetëm me mbylltore të shurdhëta dhe të zëshme jo të frymëtuara); *gjuhë me tri kategori mbylltoresh* si p. sh.: armenishtja lindore, dhe gjuha thai (ose gjuhë vetëm me mbylltore të shurdhëta dhe të zëshme jo të frymëtuara dhe të shurdhëta të frymëtuara), ose si gjuha koreane (me mbylltore të shurdhëta, të shurdhëta të frymëtuara lehtë dhe të frymëtuara fortë); *gjuhë me katër kategori mbylltoresh* si p. sh.: hindishtja dhe marathishtja (me mbylltore të shurdhëta dhe të zëshme jo të frymëtuara dhe të shurdhëta dhe të zëshme të frymëtuara). Natyrisht shqipja është anëtare e grupit të gjuhëve me dy kategori mbylltoresh.

3. Metoda dhe matjet

Pyetësi i pëdorur është formuar nga 33 fjalë dyrokëshe me strukturë BZBZ, të cilat përmbajnë në trup mbylltore të shurdhëta dhe të zëshme në të gjitha kontekstet zanore të sistemit zanor të shqipes standarde; çdo çift fjalësh (me kuptim dhe pa kuptim) u fut brenda një fraze kornizë: “thashë X jo Y”, për ta shqiptuar në mënyrë sa më të natyrshme, sipas shembullit:

Thashë HAPA jo HABA	Thashë EPË jo EBË
Thashë PATA jo PADA	Thashë ETË jo EDË
Thashë FAQA jo FAGJA	Thashë EQË jo EGJË
Thashë LLAKA jo LLAGA	Thashë EKË jo EGË

Frazat u lexuan nga folësit brenda një dhome të izoluar akustikisht në Laboratorin fonetik e Universitetit të Kalabrisë, regjistrimet u bënë me aparate profesionale.

Kemi bërë dy regjistrime të pyetësit. I pari është bërë duke lejuar një lexim të pandërprerë të listave me 4–5 fraza sipas kontekstit zanor, dhe e dyta duke i propozuar një fletëz për çdo frazë, pa ndjekur një rend, në mënyrë rastësore me një ndërprerje kohore 5–6 sekondash.

Folësit. Për këtë eksperiment u zgjodhën pesë informatorë, dy shqiptarë (pedagogë të Universitetit të Tiranës), një kosovar (pedagog në Universitetin e Kalabrisë me prejardhje nga Prishtina), dhe dy arbëreshë (një pedagog në shkollën e lartë dhe një student universitar, me prejardhje nga fshatrat arbëreshe të Strigharit dhe të Shën Mitrit) me qëllim të vërfikojë prania ose mosprania e ndryshimeve nyjetimore të mbylltoreve në një areal gjuhësor homogjen por dhe divergjent².

Të dhënat. Të dhënat janë nxjerrë duke përdorur software-in Multispeech me të cilin kemi matur zgjatjen e bashkëtingëlloreve, shpërthimin dhe VOT-in. Duke pasur parasysh disa probleme teorike të shprehur nga disa fonetikanë, sipas të cilëve VOT-i mund të konsiderohet ose si pjesë e bashkëtingëllores përkatëse ose si pjesë e zanores pasuese (Hahn 1992), ne kemi zgjedhur dhe kemi matur VOT-in si pjesë e bashkëtingëllores dhe rezultatet varen drejtëpërdrejt nga kjo zgjedhje. Në tabelat e mëposhtme të dhënat paraqiten të përpunuara në mënyrë statistike, është dhënë numri i rasteve, mesatarja dhe devijimi standard nga mesatarja (Standard Deviation). Matjet janë të gjitha në mijasekonda.

² Për variantet dialektore të shqipes shih Gjinari, Shkurtaç 1997.

Megjithëse Abramson & Lisker (1977) kanë përjashtuar mbylltoret /c ɹ/ (p.sh. në hungarishte) duke i konsideruar si tinguj afrikatë, ne i analizuam për të dhënë një përshkrim të plotë të serisë së mbylltoreve të shqipës.

4. Rezultatet

Duke matur dy mënyra shqiptimi, kemi vënë re se rezultatet e nxjerrë nga Lista 1 nuk ndryshojnë shumë nga ato të Listës 2 siç mund të shihet duke krahasuar tabelat e mëposhtme 1 dhe 2 për folësin J.M. dhe grafikët përkatës:

Tabela 1 – Të dhëna: Folësi shqiptar ‘J.M.’ Lista 1										
1=Vendi i bashkëtingëllores (‘m’ në mes, ‘f’ në fillim), 2 & 6=numri i rastëve,										
3=mbyllja+VOT/shpërthim, 4 & 8= devijimi standard,										
5 & 9min-max, 7= VOT/ shpërthim										
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	
p	m	8	160,83	35,82	111,84 : 233,05	8	16,66	9,05	6,79 : 36,99	
b	m	8	-141,89	34,64	-71,14 : -178,68	7	-11,79	2,91	-7,43 : -15,39	
b	f	2	-263,25	28,77	-234,47 : -292,02	1	-13,21			
t	m	8	165,20	17,15	138,46 : 186,19	8	28,11	7,77	18,81 : 40,83	
d	m	8	-144,79	28,73	-91,98 : -189,71	8	-21,48	6,61	-12,48 : -30,57	
d	f	1	-160,14			1	-19,42			
q	m	9	177,12	31,09	130,04 : 224,36	8	96,98	14,70	82,44 : 128,28	
gj	m	9	-121,01	32,70	-74,67 : -180,95	9	-39,55	10,03	-21,86 : -58,60	
gj	f	2	-157,58	11,53	-146,05 : -169,10					
k	m	8	196,10	26,80	153,03 : 246,80	8	62,61	16,97	34,40 : 84,65	
g	m	7	-135,85	22,28	-90,09 : -163,45	7	-37,63	13,75	-14,43 : -55,59	

Grafiku 1




Tabela 1 – Të dhëna: Folësi shqiptar ‘J.M.’ Lista 2


1=Vendi i bashkëtingëllores (‘m’ në mes, ‘f’ në fillim), 2 & 6=numri i rastëve,

3=mbyllja+VOT/shpërthim, 4 & 8= devijimi standard,

5 & 9min-max, 7= VOT/ shpërthim

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
p	m	8	153,86	20,68	125,86 : 193,59	8	19,51	8,87	10,09 : 39,88
p	f					8	11,75	4,49	6,29-18,33
b	m	8	-143,04	18,52	-105,97 : -171,87	8	-9,15	3,55	-5,65 : -16,25
b	f	2	-210,27	11,93	-198,34 : -222,20	2	-7,14	3,04	-4,10 : -10,17
t	m	8	156,58	22,39	124,58 : 203,50	8	23,62	6,73	8,95 : 31,77
d	m	8	-140,69	18,91	-115,48 : -181,75	8	-19,39	4,39	-13,30 : -25,40
d	f	2	-150,32	8,91	-141,41 : -159,23	2	-10,29	0,91	-11,20 : -9,37
q	m	10	154,22	18,79	124,86 : 198,39	10	91,38	13,55	71,94 : 121,37
gj	m	10	-144,44	23,14	-65,96 : -150,16	10	-40,59	9,29	-21,99 : -54,78
gj	f	2	-159,92	18,41	-141,50 : -178,33				
k	m	8	160,17	21,44	133,49 : 192,22	8	55,99	8,82	47,46 : 73,75
g	m	8	-118,73	19,35	-98,10 : -155,19	8	-36,73	9,69	-21,64 : -55,39

Grafiku 2



Japim tani të dhënat dhe grafikët të përgjithshëm për të gjithë informatorët:

Tabela 3 – Të dhëna: Folësi shqiptar 'J.M.' Lista 1+2

1=Vendi i bashkëtingëllores ('m' në mes, 'f' në fillim), 2 & 6=numri i rastëve,
3=mbyllja+VOT/shpërthim, 4 & 8= devijimi standard,
5 & 9min-max, 7= VOT/ shpërthim

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
p	m	16	157,35	29,46	111,84-233,05	16	18,08	9,07	6,79-39,88
b	m	16	-142,47	27,78	-71,14-178,68	15	-10,38	3,52	-5,65-16,25
t	m	16	160,89	20,41	124,58-203,50	16	15,86	7,61	8,95-40,83
d	m	16	-142,74	24,40	-91,88-189,71	16	-20,43	5,70	-12,48-30,57
q	m	19	165,07	27,83	124,86-224,36	17	93,68	14,30	71,94-128,28
gj	m	19	-117,55	28,27	-65,96-180,95	19	-40,09	9,66	-21,86-58,60
k	m	16	178,14	30,19	133,49-246,80	16	59,30	13,92	34,30-84,65
g	m	15	-126,72	22,46	-90,09-163,45	15	-37,15	11,77	-14,43-55,59

Grafiku 3




Tabela 4 – Të dhëna: Folësi shqiptar ‘GJ.SH.’ Lista 2

1=Vendi i bashkëtingëllores (‘m’ në mes, ‘f’ në fillim), 2 & 6=numri i rastëve,
3=mbyllja+VOT/shpërthim, 4 & 8= devijimi standard,
5 & 9min-max, 7= VOT/ shpërthim

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
p	m	9	96,51	23,52	71,76 : 145,00	9	17,93	11,40	4,71 : 39,40
p						7	7,60	1,76	4,81 : 9,65
b	m	8	-132,80	38,27	-79,35 : -195,50	7	-7,40	1,38	-6,14 : -10,24
b	f	3	-196,49	20,08	-169,31 : -217,21	3	-8,96	3,26	-4,35 : -11,30
t	m	8	119,02	40,22	78,97 : 200,43	8	35,45	9,15	18,06 : 52,09
d	m	8	-91,00	29,43	-47,20 : -147,26	8	-11,37	3,19	-7,94 : -18,46
d	f	2	-139,35	30,13	-109,22 : -169,47	2	-16,59	0,18	-16,40 : -16,77
q	m	9	143,04	42,44	110,30 : 243,43	9	99,04	33,33	44,25 : 170,00
gj	m	9	-119,23	41,34	-65,74 : -210,00	6	-52,32	20,05	-23,95 : -77,71
gj	f	1	-117,83						
k	m	8	122,58	22,52	96,62 : 150,05	7	45,21	8,86	32,73 : 62,96
g	m	8	-114,86	23,29	-83,96 : -157,93	7	-20,82	12,15	-6,99 : -47,34

Grafiku 4




Tabela 5 – Të dhëna: Folësi arbëresh 'V.B.' Lista 2

1=Vendi i bashkëtingëllores ('m' në mes, 'f' në fillim), 2 & 6=numri i rastëve,
 3=mbyllja+VOT/shpërthim, 4 & 8= devijimi standard,
 5 & 9min-max, 7= VOT/ shpërthim

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
p	m	8	98,05	14,45	80,70 : 122,73	8	18,77	8,83	8,64 : 39,48
p	f					5	9,88	1,86	8,93 : 13,29
b	m	8	-95,81	17,77	-70,06 : -124,13	2	-7,54	0,83	-6,71 : -8,36
b	f	1	-193,95						
t	m	8	101,88	8,51	84,45 : 117,55	8	23,59	8,49	11,07 : 37,58
d	m	8	-97,13	13,90	-75,54 : -118,27	8	-12,99	4,35	-5,00 : -21,69
d	f	1	-181,88			1	-6,92		
q	m	9	112,96	18,20	88,56 : 147,95	9	57,69	13,99	34,12 : 88,77
gj	m	9	-107,93	31,98	-47,58 : -155,29	5	-16,93	10,68	-10,35 : -38,23
gj	f	2	-172,96	17,19	-155,77 : -190,15	2	-23,92	4,63	-19,29 : -28,55
k	m	9	114,43	9,45	96,93 : 125,65	9	34,65	6,81	25,64 : 45,86
g	m	8	-122,05	30,31	-83,15 : -179,17	6	-17,73	4,60	-11,03 : -24,21

Grafiku 5




Tabela 6 – Të dhëna: Folësi arbëresh ‘L.L.’ Lista 2

1=Vendi i bashkëtingëllores (‘m’ në mes, ‘f’ në fillim), 2&6=numri i rastëve,

3=mbyllja+VOT/shpërthim, 4&8= devijimi standard, 5&9min-max, 7= VOT/ shpërthim

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
p	m	9	114,16	15,05	89,15 : 142,58	9	10,99	3,76	5,05 : 16,26
p						7	8,79	1,75	5,85 : 11,81
b	m	9	-113,62	6,99	-103,61 : -125,99	8	-8,53	2,79	-4,45 : -13,12
b	f	5	-130,20	48,01	-49,41 : -182,05	4	-5,91	1,60	-4,19 : -8,23
t	m	9	125,28	12,84	102,93 : 150,68	9	16,91	4,73	11,79 : 25,85
d	m	10	-103,36	14,30	-75,46 : -123,18	9	-9,89	4,97	-5,38 : -22,11
d	f	2	-173,63	26,09	-147,54 : -199,72	2	-7,57	2,69	-4,88 : -10,26
q	m	9	137,05	18,55	95,64 : 163,77	9	81,94	14,04	62,15 : 105,78
gj	m	10	-112,40	17,18	-91,23 : -145,06	10	-44,72	16,94	-22,81 : -89,21
gj	f	2	-94,08	15,41	-78,67 : -109,48	2	49,47	1,57	-47,89 : -51,04
k	m	11	135,72	20,19	115,57 : 176,45	11	67,50	14,80	45,63 : 89,31
g	m	8	-85,15	15,45	-54,84 : -110,48	7	-29,15	9,99	-14,33 : -46,51

Grafiku 6





Tabela 7 – Të dhëna: Folësi kosovar 'A.B.' Lista 2

1=Vendi i bashkëtingëllores ('m' në mes, 'f' në fillim), 2&6=numri i rastëve,

3=mbyllja+VOT/shpërthim, 4&8= devijimi standard, 5&9min-max, 7= VOT/shpërthim

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
p	m	8	137,92	15,68	114,54 : 163,93	8	18,64	8,92	11,08-38,28
p	f					8	15,60	3,02	11,53-21,47
b	m	8	-120,94	18,72	-101,85 : -168,31	8	-8,38	1,99	-5,00 : -11,00
b	f	5	-138,78	22,20	-165,26 : -100,16	5	-6,47	1,72	-4,51 : -9,46
t	m	8	152,00	16,88	130,58 : 183,41	8	34,12	11,20	21,11 : 50,95
d	m	8	-100,15	13,44	-73,74 : -117,75	6	-14,89	4,80	-8,92 : -21,62
d	f	2	-117,78	9,56	-108,21 : -127,34	2	-11,41	2,63	-8,78 : -14,04
q	m	10	160,61	15,16	135,28 : 185,29	10	88,66	9,21	74,46 : 100,92
gj	m	9	-111,68	11,43	-96,29 : -133,33	8	-46,10	5,35	-41,01 : -55,09
gj	f	3	-127,3	13,40	-116,49 : -146,21	1	-28,95		
k	m	11	161,41	12,69	142,29 : 187,53	11	44,80	8,62	32,74 : 59,58
g	m	10	-109,77	21,74	-73,32-133,80	7	-20,80	9,88	-5,31 : -35,23


Grafiku 7




Siç del nga rezultatet dhe si mund të shihet në grafiket të mësipërm shqipja paraqet disa të dhëna interesante:

1. mbylltoret *q-gj* paraqesin njëjtën zgjatje të bashkëtingëlloreve të tjera; në bazë të zgjatjes mund vendoset se
2. mbylltoret e zëshme paraqesin një zgjatje më të madhe se sa mbylltoret të shurdhëta (me ndonjë përjashtim);
3. s'ka shumë ndryshime midis zgjatjes në fillim dhe në trup të fjalës;
4. mbylltoret të shurdhëta mund të renditen sipas zgjatjes si: *q k t p*, kurse të zëshmet kanë më lëkundje, prandaj s'mund të jepet një rend i përgjithshëm;
5. folësit arbëreshë paraqesin për mbylltoret e shurdhëta një zgjatje më të vogël sesa folësi shqiptar J.M. dhe kosovari A.B. kurse zgjatja e nyjetimit e folësit shqiptar GJ.SH. vendoset midis këtyre nëngrupe; edhe për mbylltoret e zëshme zgjatja rritet në mënyrë të qëndrueshme duke u nisur nga folësit arbëresh në drejtim të folësve shqiptarë. Në të dy rastet, me sa duket, folësi J.M. paraqet për të gjitha bashkëtingëlloret zgjatjen më të lartë;
6. mbylltoret *q gj* paraqesin një fazë mbyllëse të mirëfilltë dhe një fazë fërkimi sëcilat mbajnë një raport të qëndrueshëm (50% të zgjatjes së plotë);
7. mbylltoret e zëshme në mjaft raste paraqesin në fund të nyjetimit, para nisjes së dridhjes të tejzave, një fazë të shkurtër shurdhimi siç tregon sonogrami që vijon:

Figura 1



8. Në rastin e fjalëve të lexuara dhe të shqiptuara në menyrrë të lirshme (folësi arbëresh L.L) nuk paraqiten ndryshime të thella midis dy grupeve.




9. Për sa i përket VOT-it vihet re se për mbylltoret e shurdhëta ai çdoherë paraqitet më i gjatë për *q*, vijnë pas në shkallë *k*, *t*, *p*; edhe për mbylltoret e zëshme duket se është ruajtur i njëjti shkallëzim, por ka edhe ndonjë lëkundje të vogël.

10. Duke ballafaquar shqipen me italishten (të dhënat janë nxjerrë nga regjistrime të bëra prej Canepari-t (1982)) verifikojmë disa gjëra me interes: së pari italishtja nuk ka në sistemin e saj fonemat /c ʎ/, së dyti në italishte ka vlerë fonologjike kundërvënia bashkëtingëllore e thjeshtë kundër bashkëtingëlloreve të dyfishuara. Nga grafiku i mëposhtëm shihet se të gjitha mbylltoret e shqipes vendosen në përgjithësi në një pozitë mesatare midis zgjatjeve të bashkëtingëlloreve të thjeshta dhe të dyfishuara të italishtes. VOT-i i shqipes del pak më i gjatë sesa VOT-i i italishtes, por na duket se ai nuk luan një rol dallues nga ana fonetike midis këtyre të dy gjuhëve;


	zgjatja	vot
p		4,12
pp	145,62	10,10
b	-96,57	
bb	187,00	7,78
t		9,74
tt	260,11	16,12
d	-134,01	-3,93
dd	252,64	
k		37,99
kk	210,31	32,12
g	-81,19	-8,42
gg	200,89	18,55

	n	mbyllja +vot	s	min-maks	n	vot	s	min-maks
p	59	128,83	34,20	68,83-233,05	59	17,23	9,19	4,71-39,88
b	59	125,14	30,43	63,76-195,50	50	8,84	3,08	4,45-16,25
t	59	137,76	32,89	52,65-203,50	58	26,19	10,06	8,95-52,09
d	59	115,54	29,90	47,20-189,71	56	15,60	6,35	5,00-30,57
q	66	148,82	30,81	88,56-243,43	64	86,58	21,63	34,14-170,00
gj	66	114,42	27,56	47,58-210,00	58	41,07	14,82	10,35-89,21
k	66	148,03	33,71	72,85-246,80	66	52,37	16,35	25,64-94,97
g	57	114,47	26,10	54,84-179,17	50	29,06	13,07	5,31-55,59

Grafiku 9



11. Në fund po japim një diagramë të përgjithshëm për VOT-in, i krijuar duke ballafaquar të dhënat të përgjithshme për shqipen me të dhënat për gjuhë të tjera (marrë nga Abramson & Lisker 1977). Siç shihet më poshtë, pas anglishtes, e cila paraqet edhe mbylltore të frymëtuara vetëm në fillim të fjalës, VOT-i i shqipes për mbylltoret të shurdhëta paraqitet si më i gjati, patjetër kjo gjë do të thotë se mbylltoret e shqipes janë pak a shumë më të frymëtuara se mbylltoret e gjuhëve të tjera në grafik, dhe sidomos në pozicion fundor të fjalës. Për sa i përket mbylltorëve të zëshme, shqipja ka VOT-in negativ më të lartë sesa të gjithë të tjerat gjuhë dhe i afrohet shumë spanjishtes portorikane.



Bibliografia

- Abramson A. S. (1977), "Laryngeal Timing in consonants distinctions", *Phonetica* 34: 295-303.
- Beci B. (1977), *Le système vocalique et consonantique du parler de la ville de Shkodra (Albanie du Nord)*, Thèse pour le doctorat d'Université du 3-ème cycle, Paris.
- Belluscio G. (1993), "Premesse per una fonematica contrastiva albanese-italiano", *Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell'Università della Calabria*, 10: 211-224.
- Bevington G. L. (1974). *Albanian Phonology*. Albanische Forschungen 13, O. Harrasowitz, Wiesbaden.
- Brown W. S. Jr., R. J. Morris, R. Weiss (1993), "Comparative methods for measurement of VOT", *Journal of Phonetics* 21: 329-336.
- Buchholz O., W. Fiedler (1987), *Albanische Grammatik*, Leipzig: Verlag Enzyklopädie.

- Cimochowski W. (1951). *Le dialecte de Dushmani*, Poznań.
- Dodi Anastas (1983), *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, Fonetika, Tiranë.
- Gjinari J., Gj. Shkurtaj (1997), *Dialektologjia*, Tiranë: ShBLU.
- Haebler K. (1965). *Grammatik der albanesischen Mundart von Salamina*, Wiesbaden.
- Hahn M. S. (1992), "The Timing Control of Geminate and Single Stop Consonant in Japanese: A Challenge for nonnative Speakers", *Phonetica* 49: 102-127.
- Henton C., P. Ladefoged, I. Maddieson (1992), "Stops in the World's Languages", *Phonetica* 49: 65-101.
- Keating P. (1984), *Language* 60: 286-319.
- Ladefoged (1975), *A Course in Phonetics*, New York, Harcourt Brace Jovanovich Publishers.
- Lisker L. (1978), "In qualified defense of VOT", *Language and Speech* 21: 375-383.
- Lisker L., A. S. Abramson (1964), "A Cross-Language Study of Voicing in Initial Stops: Acoustical Measurements", *Word* 20: 384-422.
- Lowman G. S. (1932), "The Phonetis of Albanian", *Language* 8.4: 271-293.
- Trumper J. (1987), "Il vocalismo del dialetto di Matera: primi risultati, *Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell'Università della Calabria* 4, Cosenza: Brenner, 37-60.
- Weigand G. (1913), *Albanische Grammatik in Sud-gegischen Dialekt*, Leipzig.
- Whalen D. H., A. S. Abramson, L. Lisker, M. Mody (1990), "Gradient Effects of Fundamental Frequency as Stop Consonant Voicing Judgement", *Phonetica* 47: 36-49.